

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6827
E enjte, 16 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

FOL: Qeveria realizoi vetëm
48 për qind të planit
strategjik dhe operacional
në vitin 2022 | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET SEANCA PËRGATITORE PËR NISJEN E GJYKIMIT TË LIDERËVE TË UÇK-së

MBI 300 DËSHMITARË NË GJYQIN KUNDËR LIDERËVE TË UÇK-së

- Mbrojtja e liderëve të UÇK-së kërkon që procesi të mos zgjasë pa fund dhe të shkurtohet koha e paraqitjes së provave nga ZPS-ja



Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e Gjykatës Speciale në seancën përgatitore për nisjen e procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së ka bërë me dije se deri më

tani ka siguruar mbi 300 dëshmitarë që pritet të dëshmojnë në këtë proces. Në këtë kontekst, ZPS-ja ka argumentuar se i duhen rreth 600 orë për paraqitjen e të

gjitha provave. Për një gjë të tillë nuk është pajtuar mbrojtja e liderëve të UÇK-së, e cila ka kërkuar nga trupi gjyqësor ta shkurtojë kohën e paraqitjes së provave

STEFAN LEHNE: NUK JAM OPTIMIST PËR PLANIN E BE-SË PËR KOSOVËN DHE SERBINË | FAQE 6-7



BLINKENI: SERBIA DHE KOSOVA DO TË BËJNË KOMPROMISE TË VËSHTIRA | FAQE 3



AKTUALE



TËRMETI NË TURQI, MË VDEKJEPRURËSI NË HISTORINË MODERNE TË VENDIT F.2

VARHELYI: KE-ja E GATSHME TË PUNOJË PËR APLIKIMIN E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM F.3

KLINIKA EMERGJENTE, E MBINGARKUAR ME PACIENTË F.7

EKONOMI



KOSOVA, PJESËMARRËSE NË PANAIRIN E TURIZMIT NË TEL AVIV F.8

KGJK-JA I KËRKON AVOKATIT TË POPULLIT QË LIGJIN E PAGAVE TA DËRGOJË NË KUSHTETUESE F.8

SPORT



LIGA E EVROPËS SJELLË SUPER-PËRBALLJEN BARÇA - UNITED F.10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tërmeti në Turqi, më vdekjeprurësi në historinë moderne të vendit

ANKARA, 15 SHKURT - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, njoftoi të martën se më shumë se 35 000 njerëz kanë vdekur në Turqi si pasojë e tërmetit të javës së kaluar, duke e bërë atë fatkeqësinë më vdekjeprurëse që nga themelimi i vendit, 100 vjet më parë.

Teksa është pothuajse e sigurt që numri i të vdekurve do të rritet edhe më tej, shumë nga dhjetëra mijëra të mbijetuarit e mbetur të pastrehë po përpjekin të pëmbushin nevojat bazë, si gjetjen e strehimit nga i ftohti.

Vdekjet e konfirmuara në Turqi i kaluan ato të regjistruara nga tërmeti masiv i Erzincanit në vitin 1939, që vrau rreth 33 000 njerëz. Erdogan tha se 105 505 veta u plagosën si rezultat i tërmetit dhe pasgoditjeve të tij të 6 shkurtit, me epiqendër në Kahramanmaras. Pothuajse 3 700 vdekje janë konfirmuar në Sirinë fqinje, duke e çuar numrin e vdekjeve në të dy vendet në mbi 39 000.

Presidenti turk, i cili i është referuar tërmetit si "katastrofa e shekullit", tha se më shumë se 13 000 njerëz

ende po trajtohen nëpër spitale.

Duke folur në Ankara pas një takimi pesorësh të kabinetit të mbajtur në selinë e agjencisë së fatkeqësive AFAD, Erdogan tha se 47 000 ndërtesa, të cilat përmbanin 211 000 banesa, ishin shkatërruar ose ishin dëmtuar deri në pikën që duhet të demolohehen qëllimshëm. "Ne do të vazhdojmë punën tonë të fundit nga ndërtesat e shkatërruara", tha Erdogan për përpjekjet e vazhdueshme të shpëtimit.

Agjencitë e ndihmës dhe qeveritë nga mbarë bota kanë shtuar përpjekjet për të sjellë ndihmë në pjesët e shkatërruara të Turqisë dhe Sirisë.

Situata është veçanërisht e pashpresë në Siri, ku lufta civile 12-vjeçare ka komplikuar përpjekjet për t'u dalë në ndihmë të prekurve në këtë zonë, si dhe ka sjellë presione të ndryshme mbi mënyrën se si të transferohen ndihmat në vend. Disa njerëz atje thanë se nuk kanë marrë asgjë.

Ministria siriane e Shëndetësisë



njoftoi se numri i të vdekurve është 1 414 dhe 1 357 të tjerë janë të plagosur vetëm në zonat e kontrolluara nga qeveria.

Të martën Kombet e Bashkuara ndanë një shumë prej 397 milionë dollarësh për të ofruar "ndihma dëshpërimisht të nevojshme për gati 5 milionë sirianë" për tre muajt

e ardhshëm.

Deri në marrëveshjen e së hënës midis OKB-së dhe qeverisë siriane të presidentit Bashar Assad, ndihmat ishin lejuar të dërgoheshin vetëm në një zonë përmes një kalimi të vetëm kufitar me Turqinë, ose përmes territorit qeveritar. Presidenti Assad ra dakord të hapë

dy pika të reja kalimi nga Turqia në veriperëndim të vendit të kontrolluar nga rebelët për të ofruar ndihma dhe pajisje të nevojshme për miliona viktima të tërmetit. Vendkalimet në Bab Al-Salam dhe Al Rae do të jenë të hapura për një periudhë fillestare prej tre muajsh.

Vuçiçi nderon Richard Grenellin për "qasje të balancuar ndaj Serbisë"



BEOGRAD, 15 SHKURT - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, ka konfirmuar më 15 shkurt se do të nderojë ish-të dërguarin e posaçëm të Uashingtonit për dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, Richard Grenell.

Presidenti i atëhershëm i ShBA-së, Donald Trump, emëroi ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, si të dërguar të posaçëm të administratës amerikane për dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Në gusht të vitit 2021, marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës filluan të trajtohen

nga Gabriel Escobar, i cili u emërua zëvendësndihmëssekretar në Byronë e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike të Departamentit të Shtetit.

Më 15 shkurt, Vuçiçi, kur u pyet nga një gazetar për nderimin e Grenellit me rastin e Ditës së Shtetësisë së Serbisë, tha se ishte vendim që e mori personalisht pasi, sipas tij, Grenelli "avokoi për Serbinë". "Një nga të paktët që u përpoq të kishte një qasje të balancuar, u përpoq të dëgjonte palën serbe, avokoi që zëri i Serbisë të dëgjohej", u përgjigj Vuçiçi.

Presidenti i Serbisë tradicionalisht

në festën kombëtare nderon me urdhër të lartë shtetëror individë, shërbimet e të cilëve i konsideron të dalluara.

I pyetur nëse Qeveria e Serbisë e ka paguar Grenellin për lobim, presidenti i Serbisë tha: "Nuk mendoj se po, por unë nuk jam në qeveri".

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është parakusht që të dyja vendet ta vazhdojnë integrimin euroatlantik.

Beogradi zyrtar ende refuzon ta njohë pavarësinë e Kosovës të shpallur më 17 shkurt të vitit 2008.

Ukraina kërkon përsheptimin e dërgesave të armëve nga aleatët perëndimorë

KIEV, 15 SHKURT - Ukraina u ka kërkuar aleatëve të saj perëndimorë që ta përsheptojnë furnizimin me armë dhe pajisje luftarake. Kërkesa e Ukrainës vjen në kohën kur ministrat e Mbrojtjes të NATO-s përgatiten të takohen për të dytën ditë me radhë, dhe kur Rusia ka shtuar përpjekjet e saj disamujore për ta kapur qytetin lindor të Bakhmutit.

Me ofensivën e re të Rusisë në rajonin lindor të Donbasit, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, më 14 shkurt, paralajmëroi se Rusia po

përpjeket të fitojë në fushëbetejë përpara se dërgesat perëndimore të armatimit të mund të mbërrinin në Ukrainë. "Mund të them me besim se tendencat bazë mbeten të pandryshuara. Së bashku, Ukraina dhe partnerët e saj po bëjnë gjithçka për të siguruar që shteti terrorist të humbasë. Dhe që kjo të ndodhë sa më shpejt", tha Zelensky në fjalimin e tij të natës.

Në ditën e parë të një takimi dyditor në Belgjikë, ministrat e mbrojtjes të NATO-s treguan ngurrim për të dërguar avionë

luftarakë diçka që zyrtarët ukrainas e kanë kërkuar vazhdimisht.

Numri i vendeve që janë zotuar të dërgojnë tanke në Ukrainë është rritur në 11, tha generalin Mark Milley, kryetar i Shefave të Shtabit të Përbashkët të ShBA-së, në një konferencë shtypi pas takimeve të Brukselit; 22 vende janë zotuar të dërgojnë automjete luftarake të këmbësorisë, 16 po dërgojnë artileri dhe municione dhe nëntë po dërgojnë sisteme të mbrojtjes ajrore.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes,



Lloyd Austin, premtoi ndihmë shtesë dhe armatime, por ai tha

se nuk mund të thotë asgjë sa i përket avionëve.

Varhelyi: KE-ja e gatshme të punojë për aplikimin e Kosovës për anëtarësim

BRUKSEL, 15 JANAR - Në seancën plenare të Parlamentit Evropian të martën pasdite është zhvilluar një debat për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Shumica e deputetëve janë angazhuar që Komisioni Evropian ta përshpejtojë procesin e zgjerimit në mënyrë që të mos hyjë përsëri në një fazë të ngadalshme, siç ka qenë në pesë vjetët e mëparshëm. Në këtë debat mori pjesë edhe komisionari për Zgjerim, Oliver Varhelyi. Ai tha se vitin e kaluar ishte një prej viteve më të frytshme në procesin e zgjerimit.

Në vitin 2022 Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nisën negociatat për anëtarësim në BE. Moldavia, Ukraina dhe Bosnjë-Hercegovina morën statusin kandidatit, ndërsa Gjeorgjia u cilësua kandidatë potenciale.

Varhelyi kërkoi që edhe Parlamenti Evropian, për ta mbajtur ritmin e duhur edhe këtë vit, duhet të japë sinjale pozitive për procesin e zgjerimit.

Ai, si dëshmi se BE-ja tash e ka prioritetin vërtet zgjerimin, përmendi edhe faktin se në katër takimet radhazi të Këshillit Evropian, zgjerimi ishte temë e diskutimit.

Varhelyi gjatë debatit është pyetur edhe për vendet e rajonit veç e veç. Një prej pyetjeve ishte edhe për “dosjen e Kosovës”, apo më saktësisht për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Por, a është problem për procesin

e zgjerimit që Kosova nuk është njohur nga pesë shtetet e bllokut dhe a do të thotë kjo se Kosova nuk mund të lëvizë në procesin e integritimit. “Të gjithë e dimë se cili është qëndrimi ligjor për statusin e Kosovës. Pesë vende nuk e kanë njohur Kosovën si shtet dhe kjo ndikon në qasjen tonë. Kosova ka aplikuar për anëtarësim dhe tash, presidenca suedeze është duke shqyrtuar opsionet. Nga ana jonë, ne jemi të gatshëm ta kryejmë punën tonë, e kjo është ta përgatitim mendimin për status kandidatit, por vendimi nuk na takon neve, por Këshillit”, u përgjigj ai.

Komisionari evropian u pyet edhe për atë që është cilësuar si “dështim i Kosovës” që t’i zbatojë marrëveshjet e arritura në dialogun me Serbinë, për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Do të ishte më së miri të përgjigjem duke cituar konkluzat e Këshillit Evropian nga java e kaluar. Dhe aty u bë qartë se cilat janë kushtet për përparim në rrugën evropiane”, tha ai duke cituar pjesën e cila fton direkt që pa kushte të zbatohen të gjitha obligimet nga e kaluara, në veçanti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. “Rruga evropiane e Kosovës, sikurse edhe ajo e Serbisë, shkon përmes dialogut dhe zbatimit të marrëveshjeve”, shtoi ai.

Për Malin e Zi, Varhelyi tha se ky shtet ka humbur disa vjet për



shkak të ndasive të brendshme politike, që kanë penguar reformat. “Për fat të keq, Mali i Zi i ka humbur deri tash më shumë se tre vjet pa përparim domethënës në procesin e zgjerimit. Ky shtet ka qenë vend udhëheqës në proces. Por, për shkak të ndasive politike brenda shtetit, ky shtet nuk ka qenë në gjendje të lëvizë përpara në reforma e, si rrjedhojë, as në procesin e negociatave të anëtarësimit”, tha ai.

Ai u pyet edhe për dështimin e Serbisë që të përshtatet me politikën e jashtme të BE-së rreth sanksioneve ndaj Ruisë si dhe përhapjes së propagandës ruse në Serbi, por edhe rreth ndikimit të shërbimeve të zbulimit nga Rusia që ta destabilizojnë rajonin. “Është e qartë se Serbia është vend kandidat dhe për të vlejnjë kushtet e njëjta. Po ashtu, edhe përshtatja me politikën e jashtme është kusht dhe kemi kërkuar nga Serbia të jetë

në anën tonë, përfshirë edhe sanksionet ndaj Ruisë. Është e qartë edhe politikisht për të gjithë ata që ndjekin procesin e negociatave me Serbinë, ky është ndoshta edhe problemi kryesor në negociata. Por, përshtatja në politikën e jashtme si kusht për suspendim formal të negociatave, mund të ketë ndikim jo të mirë dhe këtë e kemi parë në rastet e tjera. Ky mbetet si mjet i fundit”, tha Varhelyi.

Blinken: Serbia dhe Kosova do të bëjnë kompromise të vështira

PRISHTINË, 15 SHKURT - Udhëheqësit e Serbisë dhe të Kosovës do të “bëjnë kompromise të vështira” për t’i normalizuar marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës të cilat do të sjellin siguri dhe prosperitet për të gjithë qytetarët e Ballkanit Perëndimor, tha sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, përmes një letre drejtuar Serbisë me rastin e Ditës së Shtetësisë, më 15 shkurt. “Jam i bindur se normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të sjellë siguri dhe prosperitet për Serbinë dhe të gjithë qytetarët e Ballkanit Perëndimor. Sigurisht, liderët serbë dhe kosovarë do të bëjnë kompromise të vështira për t’i arritur këto qëllime, por shpërblimet për popullin serb dhe gjithë rajonin do të jenë të mëdha”, ka shkruar Blinken.

Në letrën drejtuar Serbisë në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, thuhet se ShBA-ja vlerëson partneritetin strategjik që ka me Serbinë “për të çuar përpara një të ardhme më të qëndrueshme dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Ballkanit



Perëndimor”. Sekretari Blinken, ndër të tjera, tha se ShBA-ja është mbështetëse

e fortë e ambicieve të Serbisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe përshëndeti

“angazhimin konstruktiv të Serbisë me zyrtarët e ShBA-së, BE-së, Francës, Gjermanisë dhe

Italisë gjatë një vizite të fundit në Beograd”.

Blinken, gjithashtu, i bëri thirrje Serbisë ta mbështesë Ukrainën kundër luftës së paprovokuar të Ruisë. “Shtetet e Bashkuara mirëpritën mesazhet e Serbisë për mbështetjen e Ukrainës në Kombet e Bashkuara dhe ne duhet të jemi të bashkuar në mbështetjen e të drejtës së popullit ukrainas për të zgjedhur të ardhmen e tyre”, tha sekretari amerikan i Shtetit.

Serbia është shteti i vetëm në Evropë që nuk vendosi sanksione ndaj Ruisë pas pushtimit të Ukrainës më 24 shkurt.

Blinken në letrën e tij vuri theks edhe te Memorandumi i Mirëkuptimit për krijimin e pozicioneve ndërlidhëse për diplomatët serbë brenda Departamentit të Shtetit të ShBA-së. “Ky program unik jo vetëm që do të nxisë një kuptim më të mirë të synimeve dhe objektivave tona të politikës së jashtme përkatëse, por do të krijojë kanale të reja komunikimi dhe do të ndërtojë partneritete të qëndrueshme”, tha ai, duke përfunduar letrën me një urim për gjithë popullin e Serbisë.



MBAHET SEANCA PËRGATITORE PËR NISJEN E GJYKIMIT TË LIDERËVE TË UÇK-SË

Mbi 300 dëshmitarë në gjyqin kundër liderëve të UÇK-së

- Mbrojtja e liderëve të UÇK-së kërkon që procesi të mos zgjasë pa fund dhe të shkurtohet koha e paraqitjes së provave nga ZPS-ja

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e Gjykatës Speciale në seancën përgatitore për nisjen e procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së ka bërë me dije se deri më tani ka siguruar mbi 300 dëshmitarë që pritet të dëshmojnë në këtë proces. Në këtë kontekst, ZPS-ja ka argumentuar se i duhen rreth 600 orë për paraqitjen e të gjitha provave. Për një gjë të tillë nuk është pajtuar mbrojtja e liderëve të UÇK-së, e cila ka kërkuar nga trupi gjykatës ta shkurtojë kohën e paraqitjes së provave. Sipas mbrojtjes, ZPS-ja ka "mungesë të qartë fokusi" në mënyrën si është paraqitur rasti ndaj liderëve të UÇK-së. Madje mbrojtja ka thënë se prokuroria është duke e penguar të bëjë pyetje në gjykim pasi, sipas mbrojtjes, ka shumë materiale të redaktuara të intervistave të dëshmitarëve. Pas diskutimeve ZPS-ja dhe mbrojtja janë pajtuar që gjyqi ndaj liderëve të UÇK-së të nisë më 3 prill

mënyrë që, sipas saj, të ketë proces të drejtë gjyqësor. Ndërsa mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka kërkuar që procesi të mos zgjasë pa fund. Po ashtu, mbrojtja ka kërkuar nga trupi gjykatës që ta shkurtojë kohën e paraqitjes së provave nga ZPS-ja. Sipas mbrojtjes së liderëve të UÇK-së, ZPS-ja ka "mungesë të qartë fokusi" në mënyrën si është paraqitur rasti ndaj klientëve të tyre. "Të gjithë vijmë te pika që në fund do të kemi një material shumë të gjerë, që askush nuk e di sa i rëndësishëm është. Avantazhi i prokurorisë është që në këtë mënyrë e shtyn çështjen, duke futur sa më shumë materiale në proces", ka thënë avokati mbrojtës i Kadri Veselit, Ben Emmerson. Emmersoni ka përshkruar se si ZPS-ja në mënyrë krejt të tërthortë ka planifikuar t'i paraqesë ngjarjet në aktakuzën ndaj liderëve të UÇK-së. "Ka një mungesë fokusi nga prokuroria për mënyrën se si çështja është paraqitur. E pranoj që vendimi i trupit gjyqësor për t'ia lënë prokurorisë për të vendosur për çështjen e vet, por ju e ngritët çështjen se paraqitja e provave në mënyrë rastësore, s'do t'i ndihmojë ata. Keni për ta parë vetë kur të kalojmë nga Drenoci,

në mesin e verës të 1998-s, pastaj të kalojmë te një dëshmitar tjetër që ka të bëjë me një pjesë krejt tjetër kah fundi i 1999-s", ka thënë Emmersoni. Ai ka thënë se mbrojtja është e penguar nga prokuroria për të bërë pyetje në gjykimin pasi, sipas tij, ka shumë materiale të redaktuara të intervistave të dëshmitarëve. "Ne duhet të njohim një zonë të madhe për të cilin flasim dëshmitarët. Është një sfidë shumë e përbërë. Do të vijë një dëshmitar i rëndësishëm shembull, që do të dëshmojë një ngjarje për Drenocin, ka një grup tjetër pastaj që do të vijë për të cilën nuk janë hequr redaktimet dhe ne nuk dimë se çka do të thonë ata. Ne jemi të penguar për të bërë pyetje. Premisa bazë është që Prokuroria të zgjedhë se si ta organizojë çështjen, por pasojat që ne do të kemi. S'ka strukturë dhe fokus nga ana e prokurorisë. Ky është një problem i madh dhe i dukshëm. Gjykimi nëse do të jetë i gjatë do të jetë në dëm të të akuzuarve që rrinë në burg, dy vjet para se të nisë gjykimi. Një nga gjërat që mund të bëni ju është ta përdorni diskrecionin për të bërë këtë gjë", ka thënë Emmersoni, duke shtuar se

te jzgjatja e procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së është në dëm të tyre dhe drejtësisë. "Do të kemi një material shumë të gjerë që askush nuk e di sa i dobishëm është. Avantazhi i prokurorisë është që të zgjatet çështja, duke hedhur sa më shumë informacion. Është mirë ndonjëherë që t'ia japësh sa më të gjatë litarin prokurorisë dhe të shohim nëse ajo do ta varë veten me të. Por nuk është koherente. Është në dëm të kësaj. Është një çështje se si ndihet ajo. S'mund të bazohesh vetëm në shifra pa i futur ato në një kontekst. Nuk bëhet krahasimi në mënyrë matematike dhe nuk pajtohem", ka thënë Emmersoni. Më tutje, Emmersoni ka paraqitur edhe paradoksin e madh, ku për çështjen kundër kasapit të Ballkanit, Slobodan Milloseviq, ishin dashur 360 orë, teksa për rastin ndaj krerëve të UÇK-së është duke u kërkuar dyfishi. "Aktakuza ndaj Milloseviqit, ku filloi fushata në Ballkan. Unë besoj që në këtë rast, periudha e aktakuzës mbuloi 10 vjet në gjithë Ballkanin. Në atë rast nuk u shtrua çështja se çfarë u urdhërua të bënin, por çfarë

EPOKA E RE

Lirim GECI

HAGË, 15 SHKURT - Të mërkurën është mbajtur seanca përgatitore për nisjen e gjyqimit në rastin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në këtë seancë Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e Gjykatës Speciale të Kosovës ka bërë me dije se deri më tani ka siguruar mbi 300 dëshmitarë në

rastin e liderëve të UÇK-së. Sipas ZPS-së, në procesin e gjyqimit ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit do të përmenden mbi 40 vende ku pretendohet se janë kryer krime. Prokuroria dhe pala mbrojtëse kanë thënë se pajtohen që procesi gjyqësor të nisë më 3 prill. ZPS-ja ka argumentuar se i duhen rreth 600 orë për paraqitjen e të gjitha provave deri kah fundi i vitit 2024 apo fillimi i vitit 2025 në

bënë. Prokuroria paraqiti faktet e saj. Ajo mori 360 orë për ta paraqitur, teksa në rastin tonë po duhet dyfishi. Te rasti i Millosheviqit do të duhej 20 vjet nëse do të vazhdonte me këtë logjikë si tani”, ka thënë ai.

Përgjatë konferencës, gjyqtari Charles Smith III ka kërkuar nga ZPS-ja të konfirmojë nxjerrjen e të gjitha materialeve që i ka.

Prokuroria ka thënë se mund të ketë edhe 700 dokumente shtesë për t'i prezantuar, përveç 56 mijë dokumenteve që tashmë ka thënë se i ka dorëzuar mbrojtjes. Avokati mbrojtës i Jakup Krasniqit, Aidan Ellis, ka thënë se beson që mbrojtjes ende nuk i janë dorëzuar të gjitha materialet që i ka prokuroria.

Gjykatësi Smith III ka thënë, po ashtu, se beson se mbrojtja nuk është pajisur me të gjitha dokumentet. “Elementi i nxjerrjes së materialeve është thelbësor për një proces të rregullt gjyqësor dhe nuk është detyrë dytësore e prokurorisë. Çdo që keni në zotërimin tuaj do të duhej të ishte nxjerrë. Nuk ka asnjë arsye për këtë gjë. E kuptoj nëse (materialet) i keni marrë dje ose pardje dhe duhet të jepni njoftim por, nga ana tjetër, duhet të keni parasysh se ne do ta fillojmë procesin gjyqësor së shpejti”, ka thënë gjykatësi Smith III.

“Fajtor autori, jo komandanti”, avokati i Thaçit me akuza ndaj ZPS-së

Në këtë konferencë përgatitore ka folur edhe avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe. Ai ka hedhur akuza ndaj Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) për kohën e kërkuar për paraqitjen e çështjes së saj ndaj liderëve të UÇK-së.

Keohe ka thënë se ZPS-ja ka paraqitur mijëra faqe të grumbulluara, pa specifikuar se cilat prova i duhen në këtë proces gjyqësor. “Kemi pasur deklarata të dëshmitarëve prej 30 faqeve dhe ne i shikojmë nëse ato janë në rregull me filan rregull dhe gjykata gjithashtu e shikon dhe jep vendimin në bazë të rregullave. Ne kemi mijëra faqe dëshmish. Një Zot e di se sa shumë ka për shumë çështje. Ata duhet të përfshijnë edhe informacion që ata mund ta kenë marrë nga palë të treta apo të katërta, pa marrë udhëzim nga prokuroria. Ata na i lënë në dorë”, ka thënë avokati i Thaçit, duke kërkuar moszgjatjen e

procesit gjyqësor. “Procedurat që përmendi (ZPS) dhe që janë përmendur kundër Mlladiqit dhe Karagjiqit, në qoftë se ka ndonjë shqetësim për kohën që duhet për pyetjet shtesë, kjo është arsyeja. Ne nuk e dimë çfarë mendon prokuroria, kur shohim kohën që na duhen për pyetjet tona si palë. Nuk na intereson asnjëri, të mos zgjatet pa fund. Është e vështirë të marrësh mijëra faqe, të na i hedhësh neve dhe të shohim se çfarë do të paraqesë prokuroria si çështje. Ata duhet t'i marrin të gjitha dëshmitë, t'i vendosin në dokumentacion dhe të marrin një fakt këtu, një fakt atje dhe nuk

s'bëhet fjalë për 'ndërmarrjen e përbashkët kriminale'. Këtu po ndodhin shumë gjëra dhe kjo do ta zgjasë këtë çështje në mënyrë të konsiderueshme. A ka hapësirë këtu që ju ta ushtroni të drejtën tuaj që çështjen tuaj ta përfundoni në fund të 2024-s dhe fillim të 2025-s? Është shumë kohë”, ka thënë avokati i Thaçit.

Koha e gjykimit dhe vëllimi i materialeve përplasnin avokatët e liderëve të UÇK-së me ZPS-në

Në seancën përgatitore për nisjen e gjykimit të liderëve të

kontakte me ekipet e mbrojtjes për të parë se cilat janë pikat juridike me të cilat ata duan të diskutojnë me prokurorinë dhe nëse ka pika juridike apo faktike me të cilat do të pajtohen.

Avokati Gregory Kehoe ka thënë se nuk di çfarë të thotë pasi diskutimet nuk kanë qenë shumë efektive deri tani dhe nuk janë dakord pasi bëhet fjalë për një mori të gjerë dokumentesh që ka ZPS-ja. Ai ka thënë se vazhdojnë diskutimet në mes të palëve.

Ndërsa Ben Emmerson, avokat i Kadri Veselit, ka thënë se ZPS-ja nuk ka dhënë parashtrim sa i takon korrespondencës apo interpretimeve ligjore se cila do të

kanë dokumente që i kanë në posedim muajt e fundit dhe do të duhet të bëjnë njoftimin e duhur. Sipas tij, do të dorëzojnë një njoftim lidhur me këtë.

Më tutje avokati Kehoe ka pyetur se cili është volumi i materialit të ri sipas rregullës 103, kurse prokurori ka thënë se po mendojnë aktualisht për 700 dokumente dhe se ka disa që do t'i nxjerrin në mënyrë të drejtpërdrejtë javën që vjen, por se materialet e reja që do t'i nxjerrin në bazë të rregullës 102 (3), janë 700 dokumente. Në këtë kontekst, avokati Kehoe ka thënë se janë pothuajse në fillim të procesit dhe vazhdohet të diskutohet për nxjerrje të materialeve pavarësisht prej afateve të vendosura nga trupi gjyqësor dhe diskutimeve në dhjetor. “Besoj e mendoni se çfarë do të thotë për ne që kemi edhe 700 dokumente të tjera”, ka thënë ai, duke shtuar se kjo çështje është problematike për mbrojtjen.

Prokurori ka thënë se kjo është një çështje e paraparë në rregullën 102 (3) dhe se do të vazhdojnë të japin dokumente edhe gjatë gjithë gjykimit dhe se ky nuk është problem dhe se është paraparë në rregullore. “Nuk janë të gjitha materialet që janë vënë në dijeni tani, disa janë të rregullës 107, por janë dokumente që nuk mund të ishin njoftuar në periudha të mëparshme”, ka thënë prokurori Howling.

Ndërsa Aydan Elis ka thënë se nxjerrja sipas rregullës 102 (3) është problem për ta, pasi kur dëgjojnë se ka 700 materialet që do të nxirren, është problem për mbrojtjen. “Nuk është e qartë për çfarë dokumente bëhet fjalë dhe kam përshtypje që bëhet fjalë për materialet që do të duhej të ishin nxjerrë më përpara”, ka thënë ai, duke shtuar se nuk beson se është nxjerrë gjithë materiali që duhej të ishte nxjerrë nga ky rregull. Në anën tjetër, gjykatësi Charles L. Smith II ka thënë se nxjerrja e materialeve është esenciale për një proces gjyqësor. “Mendoj se është e vërtetë që nuk keni marrë të gjitha gjërat. Elementi i nxjerrjes së materialeve është thelbësor në proces gjyqësor dhe nuk është dytësor”, ka thënë ai.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në paraburgim në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. Ata akuzohen kinse për krime lufte. Të katërtit janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që rëndojnë mbi ta.



keni pse të ankoheni. Ne nuk kemi kohën e duhur për të ditur se për cilin fakt bëhet fjalë”, ka thënë Keohe.

Më tutje, avokati i Thaçit ka vënë në dukje edhe gabimin që ZPS-ja është duke e bërë sidomos kur thotë se të akuzuarit kanë zgjedhur objektin e akuzës. “Unë e kuptoj që ju keni përvojë sepse keni punuar në institucione të tilla, apo ne të gjithë kemi punuar. Ne vijmë tek e njëjta bazë gjeografike apo bazë krimesh. Ne po flasim për çështje që është dy herë më e madhe se Mlladiqi dhe Karagjiqi. Ne kemi këtu çdo ngjarje të cilën ZPS-ja e ka përfshirë në aktakuzë, dhe po i thotë gjykatës se objekti nuk është zgjedhur nga prokuroria, por nga të akuzuarit. Ajo që është në akuzë është kompetencë vetëm e ZPS-së. Në çështjen e Haradinajt u mor vendim për zinxhirin komandues, ku autori u mor fajtor dhe komandanti jofajtor. Të njëjtin skenar duhet ta zbatojmë. Ja po e bëjmë të njëjtin gjë. Është dikush që është gjetur fajtor, dhe jo komandanti,

UÇK-së është diskutuar edhe për nxjerrjen e materialeve nga ZPS-ja. Pasi kjo zyrë ka konfirmuar se do të nxjerrë edhe materialet të tjera për mbrojtjen dhe se bëhet fjalë për 700 dokumente, avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Kehoe, ka thënë se janë pothuajse në fillim të gjykimit dhe është duke u vazhduar të diskutohet për nxjerrje të materialeve pavarësisht prej afateve të vendosura nga trupi gjyqësor dhe diskutimeve në dhjetor.

Paraprakisht në konferencë është diskutuar edhe për pajtimet në mes të palëve për pikat juridike dhe faktike. Gjykatësi Charles L. Smith II ka thënë se më 18 nëntor 2022 ZPS-ja ka dorëzuar një listë për të cilat palët janë pajtuar. Sipas tij, ekipet e mbrojtjes kanë dorëzuar një njoftim të përbashkët të mbrojtjes lidhur me parashtrimin dhe ka pyetur palët se a ka zhvillim tjetër.

Nga ZPS-ja kanë thënë se vazhdojnë të jenë të përfshirë në diskutimet ndërmjet palëve dhe më 9 shkurt kanë filluar të kenë

jetë baza për faktet juridike. Sipas Emmersonit, ZPS-ja duhet ta sqarojë pozicionin e saj për pikat juridike dhe pastaj nëse ka pika që pajtohen do të vijojnë më tutje. Nga mbrojtja e Rexhep Selimit, po ashtu, është thënë se do t'u ndihmonte nëse prokuroria tregon se cili është pozicioni i tyre. “Duhet të dimë saktësisht cili është pozicioni i ZPS-së, se në të kundërtën jemi në të njëjtin pozicion sikurse Emmerson apo Kehoe”, ka thënë mbrojtja e Selimit.

Ndërsa Aydan Elis, avokat i Jakup Krasniqit, ka thënë se ka të njëjtin qëndrim me ekipet e tjera të mbrojtjes dhe se do të përgjigjen pasi të marrin përgjigje nga ZPS-ja.

Lidhur me nxjerrjen e materialeve, gjykatësi Smith ka kërkuar të informohet nëse i gjithë materiali që është në dispozicion sipas rregullës 104 është nxjerrë dhe nëse është bërë rishikimi i dokumenteve. Prokurori Mathew Howling ka thënë se duhet të shikojnë rregullin 102 (3), pasi

Vitia: Qeveria ka filluar veprime të rëndësishme për ndryshimin e gjendjes në shëndetësi

Prishtinë, 15 shkurt - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ishte i pranishëm në Kuvendin e Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK). Me këtë rast ministri Vitia iu drejtua anëtarëve të OMK-së me një fjalë rasti, ku i falënderoi mjekët për kontributin e dhënë në sistemin shëndetësor, në mënyrë të veçantë në vitet e fundit gjatë ballafaqimit me pandeminë

Covid-19. Ai tha se mbetet i hapur për bashkëpunim me Odën e Mjekëve me qëllim të avancimit të sistemit shëndetësor publik në vend. “Qeveria ka filluar veprimet e rëndësishme për ndryshimin e gjendjes në shëndetësi, duke filluar me miratimin e Ligjit për Pagat, ku mjekëve për herë të parë pas luftës konsideroj se u jepet rëndësia që ata e kanë

dhe pagesa më dinjitoze, për të vazhduar me investime në infrastrukturën shëndetësore”, ka thënë ministri Vitia. Ndërsa kryetari i Odës së Mjekëve, dr. Pleurat Sejdiu, falënderoi ministrin Vitia për praninë në Kuvendin e Odës së Mjekëve dhe shtoi se do të jenë aleatë të Ministrisë së Shëndetësisë ngaqë shëndeti publik është interes i përbashkët.





Stefan Lehne: Nuk jam optimist për planin e BE-së për Kosovën dhe Serbinë

Ish-përfaqësuesi i Bashkimit Evropian në bisedimet për statusin e Kosovës, Stefan Lehne, nuk beson se plani i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë do t'u jepte fund mosmarrëveshjeve mes tyre. Palët e paraqesin atë plan si "imponim prej jashtë" dhe nuk ka gjasa të jenë konstruktive në zbatimin e tij, thotë Lehne në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Për më tepër, shton ai, plani nuk e përfshin njohjen e plotë të Kosovës nga Serbia dhe kjo do t'i shkurajojë edhe vendet e tjera që nuk e njohin pavarësinë e saj

PRISHTINË, 15 SHKURT-

Z. Lehne, dikur keni qenë në pozitën e të dërguarit të posaçëm të BE-së për çështjen e statusit të Kosovës, si do ta përshkruanit Kosovën sot, 15 vjet pas shpalljes së pavarësisë?

Stefan Lehne: Mendoj se Kosova ka bërë shumë përparim në shumë aspekte, por ka edhe shumë të meta. Nuk është vend i rregulluar. Dhe, disa nga gjërat që dëshiron t'i bëjë, janë ende të bllokuara nga çështja e statusit ende të pazgjidhur plotësisht.

Për çfarë konkretisht e keni fjalën?

Stefan Lehne: Më konkretisht për perspektivën evropiane. Kosova

ka aplikuar për anëtarësim në BE, dhjetorin e kaluar. Ka Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit [me BE-në], që ka qenë një fillim i mirë. Do të ketë liberalizim të vizave, që është një përparim i madh, edhe pse shumë i vonuar. Por, përparimi drejt anëtarësimit në BE, drejt negociatave të zgjerimit, mbetet jashtëzakonisht i vështirë, sepse pesë vende të BE-së nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur. E, që Kosova të lëvizë përpara në këtë proces, duhet dakordimi i të 27 vendeve anëtare.

Tensionet midis Kosovës dhe Serbisë mbeten po ashtu të larta,

me gjithë përpjekjet e Bashkimit Evropian për t'i normalizuar marrëdhëniet mes tyre qysh nga viti 2011. Tani po bëhet një tjetër përpjekje për të ndërmjetësuar një marrëveshje - përmes të ashtuquajturit plan të BE-së. Si e shini ju këtë plan?

Stefan Lehne: Siç e dini, ai ndjek pak modelin e dy Gjermanive të fillimit të viteve '70. Është një ide që nuk është krejtësisht e re. Mendoj se [Wolfgang] Ischinger [ish i dërguari i BE-së për statusin e Kosovës] ka folur për të në vitin 2007. Por, përpjekjet e tanishme duket se kanë gjetur tërheqje më të madhe, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi. Presidenti [i Serbisë, Aleksandar] Vuçiq është shprehur i hapur në këtë drejtim. Kryeministri [i Kosovës, Albin] Kurti e ka pranuar, po ashtu, si bazë për negociatave. Por, mendoj se shumë çështje mbeten të hapura. Vuçiq mendon se Asociacioni i komunave [me shumicë serbe në Kosovë] duhet të themelohet përpara angazhimit në këtë proces, ndërsa Kurti i sheh ndryshe prioritetet. Mendoj se ka ende shumë gjëra që duhen zgjidhur. Por, ajo që është pozitive, është se

të dyja palët duket se janë të gatshme të angazhohen në këtë proces në një mënyrë serioze.

A mendoni se ky plan do t'u jepte fund mosmarrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë?

Stefan Lehne: Nuk jam i sigurt. Ajo çfarë më shqetëson është se të dyja palët e paraqesin këtë si diçka të imponuar nga jashtë, nga BE-ja, nga SHBA-ja. Ato nuk e paraqesin atë si diçka që, në thelb, është zgjidhje e mirë për problemet. Sipas tyre, është diçka që nuk e duam, nuk na pëlqen, e urrejmë, por duhet ta pranojmë, sepse nuk kemi zgjidhje. Në të kundërtën, rruga drejt BE-së bllokohet, amerikanët nuk do të jenë të kënaqur e kështu me radhë. Kjo nuk më mbush me shumë optimizëm. Sepse, nëse bëni diçka që ju imponohet prej dikujt tjetër, atëherë nuk ka gjasa që të jeni shumë konstruktivë në procesin e zbatimit. Ka shumë çështje që duhet të zgjidhen dhe kjo e zvogëlon optimizmin tim.

A do të ishit më optimist nëse ky plan do ta përfshinte edhe njohjen reciproke mes Kosovës dhe Serbisë?

Stefan Lehne: Po, mendoj se

shkon në këtë drejtim. Sipas dokumenteve që kanë rrjedhur, të dyja vendet do t'i zbatojnë parimet e Kartës së OKB-së, sa i përket integritetit territorial, pavarësisë, mospërdorimit të forcës kundër njëra-tjetrës, mosbllokimit të anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare... Ky padyshim se do të ishte një përparim i madh, por ai nuk e përfshin njohjen e plotë të Kosovës nga Serbia. Kjo do të thotë se edhe vendet e tjera, që nuk e kanë njohur Kosovën deri tash, mund të hezitojnë të lëvizin në këtë drejtim. Mendoj se, në thelb, janë tri motive për mosnjohjen e Kosovës. I pari përfshin vendet që, në përgjithësi, janë skeptike ndaj nismave perëndimore. Do të përmendja Kinën, Indinë, Afrikën e Jugut... Pastaj janë vendet që kanë një miqësi të veçantë me Serbinë. Kjo, qartazi, është Rusia. Deri në një masë ndoshta edhe Greqia. Dhe vijnë vendet që kanë vetë probleme me pakicat, çështje të pazgjidhura të statusit, kanë arsye të brendshme politike. Këtu e kam fjalën për Spanjën, Qipron, Rumaninë, Sllovakinë... Pra, ka

Kurti merr pjesë në konferencën "Kosova dhe Urbanizmi i Ri..."

PRISHTINË, 15 SHKURT - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, mori pjesë në hapjen e konferencës "Kosova dhe Urbanizmi i Ri: qëndrueshmëria, inovacioni, teknologjia, qëndrueshmëria dhe investimet" të organizuar nga Kolegji UBT në bashkëpunim me Federatën Panshqiptare të Amerikës VATRA dhe me Rrjetin e Bizneseve të Diasporës Shqiptare. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se është nder prania e tij sot në prag të 15-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe të

merite pjesë në këtë konferencë të rëndësishme për të diskutuar, në frymë shkencore e profesionale, për të ardhmen e qëndrueshme të qyteteve tona dhe për të ardhmen e qëndrueshme të shoqërisë sonë. "Urbanizmi i Ri, me premisat e tij për të ndërtuar qytete më të qasshme, më të jetueshme, më funksionale e me më shumë vlera estetike, më të sigurta, miqësore ndaj këmbësorëve e biçiklistëve, hapësira publike më kreative e më të gjalla, është ndër përpjekjet bashkëkohore për të ndërtuar qytete që kanë në

qendër të vëmendjes njeriun dhe natyrën", u shpreh kryeministri Kurti.

Ai tha se, përveç Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, janë edhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, të cilat, në bashkëpunim horizontal me ministrinë e tjera dhe me bashkëpunim vertikal e direkt me pushtetin lokal, janë duke ndërtuar politika e duke realizuar projekte që sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe rritin cilësinë e jetesës.



një përzjerje motivesh. Dhe unë kam dyshime, që nëse Serbia nuk e njeh qartazi pavarësinë e Kosovës, këto vende që kanë probleme të mëdha të brendshme, si Spanja, Qiproja, do ta bëjnë të njëjtën gjë. Pastaj është edhe anëtarësimi në OKB. Në parim, nëse Serbia nuk do ta bllokonte më Kosovën nga anëtarësimi në OKB, ky do të ishte një hap i madh përpara për Kosovën. Por, nuk mendoj se Rusia, në këtë kohë, kur është në luftë me botën perëndimore, nuk do ta bllokojë [Kosovën] në Këshillin e Sigurimit. Pra, edhe nëse Serbia do të ishte e gatshme ta pranonte anëtarësimin e Kosovës në OKB, kjo nuk do të ndodhte, sepse

Rusia nuk do ta lejonte.

Kosova është po ashtu nën presion për ta formuar Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Shumë në Kosovë, përfshirë kryeministrin Albin Kurti, shprehën të shqetësuar se ai do të krijojë një mini-shtet ose një tjetër Republika Sërpska. A do të ishte Asociacioni rrezik për sovranitetin e Kosovës?

Stefan Lehne: Varet tërësisht nga mënyra se si zbatohet. Mendoj se idetë themelore të marrëveshjes së vitit 2013 [për krijimin e Asociacionit] janë plotësisht në përputhje me kapacitetet e Kosovës për të funksionuar si shtet unitar. Do të ishte një lloj autonomie e kufizuar dhe mund

të jetë me kompetenca të kufizuara. [Asociacioni] është diçka që Kosova e ka pranuar dhe më pas është bllokuar për arsye të ndryshme të brendshme. Është diçka që Kosova duhet ta zbatojë dhe varet tërësisht nga mënyra se si rregullohet. Në vitet e fundit nuk e kam përcjellë shumë afër për t'ju thënë saktësisht se çfarë duhet bërë. Por, është diçka që Kosova duhet ta sjellë në tryezë. Pa lëvizur në këtë drejtim, i gjithë procesi do të bllokohet.

Problem kryesor në Kosovë janë kompetencat e tij ekzekutive. Si duhet të duket ky asociacion sipas jush?

Stefan Lehne: Nuk dua të futem në detaje dhe spekulime. Mendoj se [duhet të jetë] një autonomi e kufizuar. Sigurisht që duhet të jetë kuptimplotë. Komunat me shumicë serbe do të duhej të ishin në gjendje të organizonin vetë pjesë të përditshmërisë. Por, nuk duhet të jetë një Republika Sërpska, nuk duhet ta ketë mundësinë e bllokimit të funksionimit të shtetit të Kosovës. Mendoj se ka shembuj të ndryshëm ku funksionojnë struktura të tilla, por varet nga mënyra se si zbatohen. Nuk dua të futem në detaje, sepse ka vite që nuk e kam përcjellë nga afër.

Por, unë do të doja t'ju pyesja edhe një pyetje në lidhje me këtë. Kryeministri Kurti i referohet Asociacionit si "Ahtisaari Plus" dhe thotë se Kosova tashmë i ofron pakicës serbe mjaft të drejta dhe përfitime. A i ofron?

Stefan Lehne: Në vitin 2013,

Kosova ka pranuar që të bëjë më shumë se paketa e Ahtisaarit. Paraardhësit e Kurtit janë angazhuar që të veprojnë në këtë drejtim. Bashkimi Evropian dhe komuniteti ndërkombëtar e presin këtë nga Kosova. Komuniteti ndërkombëtar është i bindur se mund të bëhet në atë mënyrë që nuk e kërcënon ekzistencën apo funksionimin e shtetit të Kosovës. Çështja është se si do të zbatohet.

Cilat janë gjasat që Asociacioni ta zgjidhë konfliktin midis Kosovës dhe Serbisë?

Stefan Lehne: Jo plotësisht. Ka bagazh të madh historik në të dyja anët. Dhe, nuk ka gjasa që Kosova dhe Serbia të jenë mikut më të mira në 10-15 vjetet e ardhshëm. Por, është një proces drejt normalizimit. Do ta zhblokojë rrugën e anëtarësimit në BE si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë. Do ta lehtësojë shumë bashkëpunimin ekonomik mes dy palëve. Mendoj se, në përgjithësi, është një gjë shumë pozitive, por nuk pres mrekulli. Nuk shoh një pajtim të madh. Mendoj se problemi është thellë në psikikën kombëtare në të dyja anët. Nuk ka gjasa të kapërcehet shumë shpejt.

Kosova njihet nga më shumë se 100 vende. Megjithatë, viteve të kaluara, ritmi i njohjeve është ngadalësuar. Pse mendoni se ka ndodhur kështu?

Stefan Lehne: Mendoj se Serbia ka bërë një fushatë shumë aktive për çnjohjen e Kosovës dhe ka

pasur një sukses të kufizuar. Serbia beson se rreth 84 vende e njohin Kosovën, ndërsa Ministria e Jashtme e Kosovës thotë se janë 117 vende. Shumë vende janë sjellë në një mënyrë shumë të paqartë. Kanë dërguar disa sinjale pozitive, pastaj i kanë tërhequr ato, pastaj i kanë konfirmuar... Mendoj se për një vend në Jugun Global kjo nuk është një çështje shumë e rëndësishme. Kur takojnë një ministër serb, thonë diçka tjetër, e kur flasim me një ambasador amerikan, thonë diçka tjetër. Nuk mendoj se bën ndonjë dallim të madh nëse janë 100 vende apo 110 vende [që e njohin Kosovën]. Dallimin e bëjnë shtetet mosnjohëse të BE-së, sepse ato e bllokojnë përparimin.

A paraqet ndonjë rrezik për Kosovën fushata e çnjohjeve e Serbisë?

Stefan Lehne: Mendoj se është e bezdisshme për Kosovën. Nuk ndryshon asgjë. Shtetet e rëndësishme, shumica e shteteve perëndimore që e kanë njohur Kosovën, nuk do të zhbinden nga zyrtarët serbë. Nëse Togoja e njeh Kosovën, nuk është shumë e rëndësishme. Pra, nuk mendoj se [fushata e Serbisë] paraqet kërcënim për Kosovën, por besoj se është shumë e bezdisshme. Mendoj se është e rëndësishme për Serbinë që ta ndalojë këtë. Mendoj se plani që tani është në diskutim, do ta ndalojë këtë. Mendoj se dy palët do të angazhohen që të mos bëjnë ndonjë gjë të tillë në të ardhmen.

Klinika Emergjente, e mbingarkuar me pacientë

PRISHTINË, 15 SHKURT - Mbi 92 mijë pacientë janë trajtuar vetëm gjatë vitit 2022 në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Shërbimi Spitalor Klinik e Universitar i Kosovës ka njoftuar të mërkurën se kjo klinikë vazhdon të mbetet institucioni më i ngarkuar me pacientë në sistemin publik shëndetësor në vend. "Mbi 92

mijë pacientë u trajtuan në Klinikën Emergjente. Klinika Emergjente e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) vazhdon të mbetet institucioni më i ngarkuar me pacientë në sistemin publik shëndetësor në vend. Sipas të dhënave zyrtare nga kjo klinikë, 92 mijë e 615 pacientë kanë marrë shërbime mjekësore emergjente, gjatë vitit 2022. Shërbimi

Internistik, 26 mijë e 608 pacientë; Shërbimi Kirurgjik, 20 mijë e 671 pacientë; Shërbimi i Reanimacionit, 19 mijë e 809 pacientë dhe Shërbimi i Ortopedisë, 19 mijë e 861 pacientë. Po ashtu, janë kryer 1 mijë e 146 operacione në sallat operative emergjente dhe 5 mijë e 66 intervenime në sallën e vogël të intervenimeve", ka njoftuar ShSKUK-ja.



Ngadalësohet inflacioni në ShBA

WASHINGTON, 15 SHKURT - Inflacioni vjetor në Shtetet e Bashkuara u ngadalësua vetëm pak në muajin janar, treguan sot të dhënat e qeverisë amerikane, duke sinjalizuar ndalimin e tendencës së një ngadalësimi të dukshëm të rritjes së çmimeve që nga vjeshta e vitit të kaluar.

Norma vjetore e inflacionit ra

në 6.4 për qind në janar, niveli më i ulët që nga tetori i vitit 2021, tregojnë të dhënat e rregulluara sezonale nga Ministria e Punës.

Në dhjetor të vitit të kaluar ishte 6.5 për qind, në nëntor 7.1 për qind dhe në tetor 7.7 për qind. Ajo ishte në kulmin e saj në qershor të vitit të kaluar, kur arriti në 9.1 për qind, niveli më i lartë që nga nëntori

1981.

Inflacioni bazë, i cili nuk përfshin çmimet e ushqimeve dhe energjisë, u dobësua lehtë në janar në 5.6 për qind, niveli më i ulët që nga dhjetori 2021, sipas njoftimit të ministrisë. Në dhjetor ishte 5.7 për qind. Në baza mujore çmimet e rregulluara sezonale u rritën me 0.5 për qind në janar, pas një rritjeje prej 0.1-përqindësh

në dhjetor, sipas të dhënave të rishikuara. Vlerësimi i parë për muajin dhjetor tregoi një rënie të çmimeve të konsumit në krahasim me muajin nëntor me 0.1 për qind. Me përjashtim të energjisë dhe ushqimit, inflacioni mujor në janar ishte 0.4 për qind, si në muajin e kaluar, sipas tabelave të ministrisë. Çmimet e gazit u rritën më



shumë, 6.7 për qind, pothuajse dy herë më shumë se në dhjetor. Pas tij vjen benzina, e cila u rrit 2.4 për qind në krahasim me dhjetorin, kur ishte më e lirë me shtatë për qind.

Kosova, pjesëmarrëse në Panairin e Turizmit në Tel Aviv

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 SHKURT - Republika e Kosovës po merr pjesë në ekspozitën ndërkombëtare të Turizmit në Tel Aviv të shtetit të Izraelit. Stendën e bizneseve të Kosovës e ka vizituar edhe e ngarkuara me punë në Ambasadën e Kosovës në Jerusalem, Ines Demiri. "Ky panair është një ngjarje globale e rrjeteve dhe industrisë e krijuar për të bashkuar në një vend profesionistë nga të gjitha nivelet e biznesit dhe shërbimeve në turizëm dhe udhëtime, duke u ofruar mundësinë për të ekspozuar në 'Expo Centre' Tel Aviv", ka shkruar Demiri në rrjetet sociale.

Ky panair shërben si mundësi për takime dhe seminare shtesë për pjesëmarrësit.

Nol Krasniqi nga shoqata "Balkan Natural Adventure" e ka mirëpritur këtë ngjarje, duke shprehur se një panair i tillë e rritë gjasën që në Kosovë të vijnë më shumë turistë nga Izraeli. "Kompania jonë ka rreth 20 për qind klientë nga Izraeli dhe kjo pjesëmarrje do ta rrisë numrin e vizitorëve në Kosovë. Izraeli është një vend me standard shumë të lartë dhe njerëz që udhëtojnë shumë, e ky është potencial për ne", ka deklaruar Krasniqi. Projekti PPSE, përmes sektorit të turizmit dhe në bashkëpunim me Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (Kosovo Investment and Enterprise Support Agency - KIESA), organizuan pjesëmarrjen e disa bizneseve dhe operatorëve të turizmit në IMTM 2023.

Pjesëmarrja e Kosovës është



veçanërisht e rëndësishme pasi që vendi ynë ka punuar në mënyrë të vazhdueshme për ta zhvilluar industrinë e saj të turizmit në vitet e

fundit.

Kosova ofron një pasuri të bukurisë natyrore, si dhe trashëgimi të pasur kulturore, kuzhinë të shijshme dhe

mikpritje të ngrohtë.

PPSE është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe zbatohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.

KGJK-ja i kërkon Avokatit të Popullit që Ligjin e Pagave ta dërgojë në Kushtetuese



PRISHTINË, 15 SHKURT - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka njoftuar të mërkurën se ka dorëzuar kërkesë tek Institucioni i Avokatit të Popullit për iniciimin e procedurës për kontrollin e kushtetutshmërisë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik. Këshilli konsideron se ky ligj është në kundërshtim me Kushtetutën, me Ligjin për Gjykatat, rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi pavarësinë e gjyqësorit, opinionin e Këshillit

Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO 203/19. "Prandaj, Këshilli kërkoj nga Avokati i Popullit që në kuadër të kompetencave të veta kushtetuese dhe ligjore të ndërmarrë veprime të nevojshme për adresimin e kësaj kërkesë në Gjykatën Kushtetuese", thuhet në komunikatën për medie. Më 1 shkurt Qeveria e Kosovës ka miratuar koeficientin e Ligjit të Pagave në Sektorin

Publik në vlerë prej 105 eurosh. Ligji i Pagave rregullon çështjen e pagave për mbi 82 mijë punëtorë të sektorit publik. Megjithatë, ka pasur pakënaqësi të disa sektorëve. 18 ankesa janë deponuar tek Avokati i Popullit që Ligji të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese.

Me Ligjin e ri për Paga niveli i koeficienteve është nga 2 deri në 18. Presidentes së shtetit i është caktuar koeficienti më i lartë, sipas të cilit, ajo do ta ketë pagën më të madhe.

FOL: Qeveria realizoi vetëm 48 për qind të planit strategjik dhe operacional në vitin 2022

PRISHTINË, 15 SHKURT - Lëvizja FOL ka bërë monitorimin e Planit Strategjik dhe Operacional të qeverisë për periudhën janar-dhjetor 2022 të 15 ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit. "Prej 2 937 aktiviteteve të parapara për këtë periudhë kohore, janë realizuar 1 808 aktivitete apo 48 për qind dhe 1 129 nuk

janë realizuar apo 52 për qind", ka thënë Demolli-Nimani. Demolli-Nimani ka bërë me dije se ministrinë si (ZKM, MASHTI, MINT, MAPL, MFPT, MBPZH, MKRS, MKK) kanë planifikuar aktivitete afatgjata të cilat kanë filluar në vitin 2022, ndërkaq realizimi i tyre do të

vazhdojë në vitet në vijim.

Secila nga këto ministri ka dërguar edhe informacione shtesë sa i përket realizimit të këtyre aktiviteteve deri në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022.

FOL do të vazhdojë ta bëjë monitorimin e Planit Strategjik dhe Operacional të qeverisë edhe gjatë vitit 2023.



Kishat ortodokse shqiptare dhe uzurpimi i tyre nga shteti serb (3)

(Sllavizimi i kishave shqiptaro-bizantine të Kosovës projekte të hershme të Serbisë)



Shkruan: Faton B. MEHMETAJ

Mbreti Millutin Nemanjiq e ka meremetuar e rindërtuar këtë manastir në gjysmën e parë të shekullit XIV, por ndryshime të tjera arkitektonike janë bërë në këtë manastir gjatë disa shekujsh. Për pikturimin e afreskeve të Graçanicës sunduesi serb kishte angazhuar të njëjtit piktor shqiptar që i kishte angazhuar fisniku shqiptar Progon Zguro për zbukurimin e kishës së Ohrit-Mëhill Astrapën dhe Eutihun. Vlen të ceket se Millutini ka rindërtuar edhe disa kisha të tjera, gjithashtu me vlerë të madhe arkitektonike, si p.sh. manastirin Banjska afër Mitrovicës dhe kishën e Zojës së Bekuar (Shna-Prendës) në Prizren (Sveta Peta, Levishka), e cila ka ekzistuar si e tillë edhe para ardhjes së Nemanjiqëve në këto vise (ashtu si Graçanica). Kështu që Millutini kishte së (Shna-Prendës) në Prizren pasi e kishte marrë për vete, ja kishte rregulluar kulmin. Sidoqoftë shqiptarët kanë një histori të fuqishme, janë raca më e vjetër në Evropë (W. Peacock), kanë gjuhën më të vjetër në Evropë, gjuhën unikate me numër rekord shkronjash (36 sosh), dhe janë të parët që e pranuan krishterimin në Evropë. Pas ndarjes së kishës bizantine nga Roma në vitin 1054, krishterimi u nda në kishën ortodokse bizantine në lindje dhe kishën katolike në perëndim. Kjo ndarje ndodhi siç dihet për shkak të mospajtimeve doktrinare. Por krahina e Dardanisë gjegjësisht

Albania duke qenë e vendosur në mes përplasjeve të lindjes dhe perëndimit, kishat kontestuese u bënë zonë ku Konstantinopoja dhe Vatikani ushtruan rivalitetin e tyre. Në fillim të shek. 12, në Albani ekzistonin 20 peshkopata. Peshkopatat e Shqipërisë Veriore vareshin nga Arqipeshkvia e Tivarit, ato të Shqipërisë Qendrore vareshin nga Metropoli i Durrësit derisa ato të Shqipërisë së Jugore nga Arqipeshkvia e Ohrit. (Këto dy të fundit ishin të lidhura me Patritkanën e Konstantinopojës). Peshkopët duke qenë nënë akuzat e Papës nga Roma, ose nga Patriku nga Konstantinopoja, ndërronin ritin e tyre sipas situatës politike, duke u luhatur nga katolicizmi në ortodoksizëm dhe vice-versa. Në shekullin 11-të Prizreni ishte seli e ipeshkvisë bizantine.

Në vitin 1557, si shpërblim për kontributin që dhanë serbët për pushtimin e Hungarisë, Sulltaninën ndikimin e Mehmet Pashë Sokoloviqit, u mundësoi atyre (serbëve) të kenë patrikanën e tyre me seli në Pejë, që kishte juridiksionin mbi Maqedoninë, Bullgarinë lindore, Zetën dhe Bosnjë. Me pak fjalë Kishat ortodokse të Kosovës pa kurrfarë kundërshtimi janë monumente shpirtërore shqiptare, që u shfrytëzuan për qëllime të këqija nga okupuesit.

Me të njëjtin profil është edhe Kisha e Deçanit një manastir i vjetër liro-arbrorë që më vonë u uzurpua nga Dushani dhe suita e tij si shumica e kishave të vjetra shqiptare të cilat u përvetësuan nga serbët pasi u vendosën në këto hapësira. Manastiri i Deçanit u quaj edhe Kisha e Gashit, ngase pjesëtarët e këtij fisi e ruajtën këtë kishë me qindra vjet.


Duhet përmendur se pjesëtarët e fisit të Gashit i përkasin tri religjioneve, si p.sh. në regjionin e Pejës këtë mbiemër e mbajnë familjet myslimane, katolike dhe ortodokse (Gashiq-i). Këtu

studiuesi Slijepceviq, duke folur mbi ndërtimin e kishës së Ulpianës (Graçanicës) thotë: "Në të vërtetë, sipas shënimeve historike, ky manastir ka ekzistuar më parë, sikurse faltoret tjera para së të vinin



Kulti i Shën Angjelinës shqiptare: Angjelina ishte e bija e princit të famshëm shqiptar Gjergj Arianiti dhe e motra e Donikës, gruas së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit. Princërit shqiptarë të mesjetës shqueshin edhe për lidhjet e tyre me kishat dhe manastiret. Kult i Shën Angjelinës ka vazhduar për pesë shekuj dhe ka depërtuar edhe tek serbët. Shqiptarët deri në kohët e vona, por edhe sot, varrin e Dushanit e konsiderojnë si varr të mirë - me karakter shenjtor, si të vetin, sepse ai ishte me origjinë shqiptare, mirëpo pasi ai merr fenë ortodokse, konceptet politiko-shoqërore ndryshojnë nga ato të fesë katolike sikurse do të ndryshojnë konceptet e shumë prijësve shqiptarë pas ardhjes së Turqisë në Ballkan.

sllavët". Kisha e Ulpianës është një katedrale dhe arqipeshkvi e vjetër dhe madhështore bizantine në Dardani për një kohë të gjatë gjysh nga mesjeta e hershme. Pra objektet e përmendura më parë siç janë kisha në Lipjan, Graçanicë dhe Zonja Prene (Ljevishka) në Prizren etj, u përkasin objekteve të ndërtuara qysh gjatë shek. të VI-të dhe të VII-të ose ato të shek. të IX-të dhe të XI-të. Lidhur me këtë akademiku, D. Bogdanoviq, tregon se, dy qytete bizantine që i okupoj Stefan Nemanja, Prizrenin dhe Lipjanin, aso kohe ishin qendra fetare. Po ashtu, V. Markoviq, tregon edhe se, mbreti Millutini (1282-1321) nuk ndërtoi asnjë manastir të ri, ai vetëm i rindërtoi manastiret e vjetra që ishin aty. Edhe në Kartën e Stefan Deçanit (burim mesjetar serb i shek. të XIV-të) thuhet se: "Kisha e Shën Prenës ka ekzistuar që nga kohërat e mbretërve të stërlashtë". Një kishë tjetër e lashtë pak e përmendur është Kisha e Argjentarisë ose e Nova Bërdës, kjo kishë sot gjendet nënë gërmadhat, me siguri që nga koha e invadimeve të barbarëve. Këtu duhet përmendur edhe Kishën e Zveçanit e ndërtuar pranë kalas ilire që vazhdon të jetë fortesë bizantine vis-a-vis depërtimeve barbare për një kohë të gjatë. Ajo qëndron mbi Mitrovicë (ku gjendet faltorja kushtuar shëmitrit-Shën




Mbishkrimin e Fra Vita Kuçit mbi dyert e Manastirit të Deçanit, i pari e ka publikuar Jovan Rajic në historinë e tij (J. Rajic, Nav. delo, II, 581) e pas tij shumë autorë të tjerë. Kosta Jireçek-Radoniq, Istorija Srba, II, Beograd, 1978. Kalki i mbishkrimit është paraqitur në "Istorija srpsko gnaroda, I, Beograd, 1981, f. 644". Kurse në studimin më të vonë të G. Subotiqi, i cili merret si kronisti kryesor i jetëshkrimeve të Deçanit (kishës së Deçanit), tregon për vërtetësinë e ndërtimit të objektit të kishës që është përfunduar në sezonën e vjeshtës së vitit 1334. F. Mehmetaj, Deçani nëpër shekuj, Prishtinë 2020)

Mitrit ose Dhimitrit). Festën e Shmitrit e festojnë edhe sot e kësaj dite myslimanët edhe të krishterët në gjithë Kosovë. Si kala Zveçani ishte rindërtuar dhe zgjeruar gjatë kohës së Justinianit të Madh, si pjesë e vijës mbrojtëse të Dardanisë, si parapërgatitëse kundër depërtimeve eventuale të barbarëve. Më vonë elementi serb u mbështet fuqishëm edhe nga Rusia, në këto rrethana popat nga Rusia filluan të vinin dhe të ndaleshin në Kishat ortodokse të

Xhami herët me ardhjen e otomanëve. Kjo u hedh në dritë pas restaurimit të saj nga xhamia në kishë pas vitit 1950. Rreth këtyre kontesteve F. S. Noli shkruante: "Fakti se shqiptarët kanë qenë të krishterë, para pushtimit otoman, heshtet. Shumë nga kishat dhe manastiret në Kosovë datojnë qysh nga koha kur, para serbëve, vendin e zotëronin bullgarët, ndërsa shqiptarët kishin po të njëjtin besim". Serbët duke i vënë në lëvizje të gjitha forcat diplomatike



Kisha e Shën Premtës ose Xhamia e Xhumasë është një kishë dhe ish-xhami e vjetër në qytetin e Prizrenit. Ajo është uzurpuar dhe meremetuar në vitin 1306 nga Shtjefën Millutini, pasi kishte qenë më parë kishë latine. Mori statusin xhami në vitin 1455 nga Sulltan Mehmet Fatihu. Më 1306-1307", Shën Premtja, Shën Prenë vihet mbi themelet e një tempulli pagan të kushtuar hyjneshës ilire të pjellshmërisë dhe të lindjes, e cila u shërbeu banorëve dardanë, pastaj si bazilikë bizantine, kurse me ardhjen e serbëve Millutini e renovon në kishë ortodokse serbe të cilës edhe emri i përshtatet në Sveta Petka: kurse Bogotodica Levishka, lidhet me rrjedhën e mëhershme të lumit, i cili kalonte nga ana e majtë. Kurse me ardhjen e osmanlinjve, adaptohet në xhami të emërtuar si Xhuma Xhamia - Atëk Xhami.



Manastiri Iliro-Arbëror i Deçanit

Kosovës. Kjo ardhje e popave është pasojë e një marrëveshjeje të arritur nga Sulltan Sylejmani i I-rë me rusët që është arritur nënë ndikimin e Roksanës gruas së tij, që ishte me origjinë sllave. Na këto "restaurime" në brendësinë e kishave shpëtoi vetëm Shën Mëria e Pizrenit, meqë u shndërrua në

të kohës arritën një ujudi e bashkëpunim me otomanët që vazhdojë deri në kohërat e vona, kurse shqiptarët u diskriminuan dhe shkatërruan prej dy palëve, por mbijetuan dhe dolën triumfues sepse e drejta njerëzore dhe historike ishte në anën e tyre. (Fund)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Superkupë festive në Istog

PRISHTINË, 15 SHKURT - Në kuadër të aktiviteteve shtetërore për shënimin e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, të enjten në Istog do të luhen ndeshjet e Superkupës së Kosovës në

hendboll. Superkupa tani e tutje do të jetë tradicionale, ndërsa këtë herë është edhe festive. Ndeshjet do të luhen në palestrën e qytetit në Istog. Prej orës 15:30 është finalja e Superkupës te hendbollistët

në të mes Besa Famgasit dhe Kastriotit. Të dyja skuadrat kanë treguar formë të mirë në hapje të stinorit pranveror dhe synojnë trofeun e parë të edicionit. Ndërkohë prej orës 18:00 është finalja e

Superkupës te hendbollistët në mes të Istogut dhe Ferizajt. Istogu llogaritet në përkrahjen e shikuesve, ndërsa plane ka edhe Ferizaj. Pritet atmosferë e bukur në Istog dhe numër i konsiderueshëm i shikuesve.



Liga e Evropës sjellë superpërballjen Barça - United

"Epoka e re"

BARCELONË, 15 SHKURT - Pas Ligës së Kampionëve zhvillohen ndeshjet në Ligën e Evropës ku pritet të këtë përballje interesante. Ndeshja kryesore është ajo që zhvillohet në "Camp Nou" ku Barcelona e pret Manchester Unitedit, në ndeshjen e parë të "play-off"-it. Dy skuadrat janë përballur disa herë edhe në Ligën e Kampionëve, por është hera e parë që përballen në garën e dytë më të rëndësishme për klube. Barcelona hynë në raundet e eliminimit të Ligës së Evropës për të dytin sezon radhazi, pasi përfundoi e treta në grupin e Ligës së Kampionëve pas Bayern Munchen dhe Interit. Barcelona

ndryshe nga Liga e Kampionëve, në La Liga është duke shkëlqyer dhe është në pozitën e parë me 11 pikë para Realit që ka një ndeshje me pak të zhvilluar. Manchester United është dashur të paraqitet në Ligën e Evropës në gjashtë nga dymbëdhjetë sezonet e fundit. "Djajtë e Kuq" e nisën fazën e grupeve në mënyrë jo të mirë duke humbur me rezultat minimal 1-0 në shtëpi kundër Real Sociedad, por futbollistët e Erik ten Hag u përgjigën mirë me pesë fitore të njëpasnjëshme. Unitedi është ende duke konkurruar në të gjitha frontet këtë sezon, me një ndeshje finale të Kupës EFL kundër Newcastle United që do të vijë më vonë këtë muaj dhe një ndeshje në raundin e pestë të FA Cup me West Ham United në



mars, ndërsa ata janë vetëm pesë pikë larg vendit të parë në Premier Ligë. Tani fokusi i Unitedit do të zhvendoset në

"Camp Nou" ku do të mundohet të marrë një rezultat sa më të favorshëm për të pasur më të lehtë në ndeshjen kthyesë në

"Old Trafford". Barcelona në këtë ndeshje do të jetë pa dyshen Ousmane Dembele dhe Sergio Busquets, kurse mungesat e Unitedit janë më të mëdha: Donny van de Beek, Christian Eriksen, Anthony Martial, Scott McTominay dhe Antony. Ndërsa Lisandro Martinez dhe Marcel Sabitzer janë të dyja të pezulluara.

LIGA E EVROPËS

- 18:45 Ajax - Union Berlin
- 18:45 Barcelona - Manchester United
- 18:45 Salzburg - Roma
- 18:45 Shakhtar Donetsk - Rennes
- 21:00 Bayer Leverkusen - Monaco
- 21:00 Juventus - Nantes
- 21:00 Sevilla - PSV Eindhoven
- 21:00 Sporting - Midtjylland

FIFA rrit përkrahjen për federatat, 8 milionë euro më shumë për FFK-në



PRISHTINË, 15 SHKURT - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka theksuar se FIFA do ta rrisë përkrahjen e saj për 211 federatat anëtare në katër vjetet e ardhshme. Infantino theksoi se përkrahja e FIFA-s do të rritet për 29 %, që do t'u sillte përfitime të shumta shumë federatave, përfshirë këtu edhe Federatën e Futbollit të Kosovës. "Si trup qeverisës global ne duhet ta luajmë rolin

tonë për ta rritur nivelin e lojës në fushë për të gjithë anëtarët tanë. Ne do ta bëjmë këtë mbështetje për projektet zhvilluese, dorë për dorë me gjashtë konfederatat dhe 211 anëtarët e FIFA-s. Në ciklin katërvjeçar do ta rritim investimin për 29 % në krahasim me periudhën paraprake. Kjo rritje e investimeve është rezultat i FIFA-s së re, që të jetë më

efikase, mirë e qeverisur dhe e përshtatshme për qëllimet që i ka", ka thënë Infantino. Sipas mediumit italian "Tuttomercatoeb", 211 federatat që janë nën ombrellë të FIFA-s do t'i përfitojnë nga rreth 8 milionë euro më shumë në katër vjetet e ardhshme. Federatat nacionale, përfshirë edhe FFK-në, marrin vazhdimisht përkrahje financiare nga FIFA dhe UEFA.

Përfaqësueset e Kosovës në basketboll mësojnë kundërshtarët për garat evropiane

PRISHTINË, 15 SHKURT - Në Muniht të Gjermanisë është hedhur shorti për përfaqësueset e reja që do të garojnë gjatë verës në garat evropiane. Kosova U20 te meshkujt është caktuar në Grupin C së bashku me Suedinë, Gjeorgjinë dhe Ukrainën. Vashat e Kosovës në këtë grupmoshë janë në Grupin C së bashku me Holandën, Kroacinë dhe Slloveninë. Meshkujt e Kosovës U18, po ashtu, janë caktuar në Grupin

C, ku do të përballen me Holandën, Estoninë, Ukrainën, Rumaninë dhe Irlandën. Vashat e Kosovës për U16 do të jenë në Grupin B, së bashku me Shqipërinë, Moldavinë dhe Armeninë. Ndërsa djemtë e Kosovës U16 janë në Grupin A, së bashku me Andorrën, Moldavinë, Maltën dhe Gjibraltarin. Kosova gjatë verës do të garojë me pesë përfaqësuese. Te meshkujt do të garojnë Kosova U20 në Divizionin B, Kosova

U18 në Divizionin B dhe Kosova U16 në Divizion C, që do të organizohet në Prishtinë. Ndërsa te femrat, Kosova do të paraqitet me U20 në Divizionin B dhe me U18 në Divizionin C. Divizioni B i meshkujve për U20 do të organizohet në Shkup të Maqedonisë Veriore nga 7 deri më 16 korrik 2023. U18 i meshkujve mbahet në Matosinhos të Portugalisë nga 21 deri më 30 korrik 2023. U16 i Divizioni C do të organizohet në Prishtinë nga 19 deri më 27



korrik 2023. Te femrat U20 Divizioni B do të zhvillohet në Cracovia të Rumanisë nga 28 korriku deri më 6 gusht 2023.

Divizioni C i femrave U18 do të mbahet në Durrës të Shqipërisë nga 1 deri më 6 gusht 2023.

Prandelli largohet nga bota e futbollit: Isha i vetmuar dhe në ankth

Romë, 15 shkurt - Detyra e fundit e trajnerit italian Cesare Prandelli daton para një viti teksa ishte në krye të Fiorentinës në Serinë A, por tashmë vetë 65-vjeçari thekson se nuk i mungon më

profesioni i tij, ndërsa shtoi se fakti që po qëndron larg futbollit ia ka zbukuruar jetën. "Pasioni është gjithnjë i pranishëm, por nuk më mungon detyra e trajnerit dhe besoj se tashmë nuk ka

më kthim pas. Fakti që jam larguar nga futbollit dhe po e ndjek në distancë duket se më ka bërë mirë. Nuk ka të bëjë me depresionin, por ndihesha në ankth dhe i vetmuar që prej mbylljes së

stadiumeve si pasojë e Covid-19. E falënderoj Fiorentinën sepse më mirëkuptoi. Tani më duket sikur kam zbuluar kënaqësinë e normalitetit", ka thënë Prandelli.



Basketbollisti Drilon Hajrizi shpallet sportisti i vitit 2022 në Mitrovicë

MITROVICË, 15 SHKURT - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Mitrovicës ka mbajtur ceremoninë e shpalljes së klubeve sportive dhe sportistit më të mirë për vitin 2022. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, kryesuesja e Kuvendit, Vesa Broja, drejtorë të drejtorive komunale, sportdashës, punëtorë të sportit, si dhe përfaqësuesit e klubeve sportive dhe sportistët që u shpallën më të mirët për vitin 2022.

Në fjalën e tij nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ndihet i privilegjuar që ndodhet në mesin e sportistëve, për të cilët shprehu mirënjohjen më të lartë për kontributin e tyre në ngritjen e epitetit të Mitrovicës si qytet i kulturës, artit dhe sportit. "Për mua sot është një emocion i jashtëzakonshëm, sepse në vitin 2008 isha fitues i çmimit 'Shpresa e Vitit' në qytetin e Mitrovicës, i cili ishte një motiv dhe vullnet për mua që të kontribuoj më shumë për sportin dhe qytetin tim. Duke ju dëshiruar suksese akoma më të



mëdha, ju premtoj se mbështetja institucionale për ngritjen dhe avancimin e sportit në qytetin tonë nuk do të mungojë asnjëherë", është shprehur nënkryetari Tahiri, i cili i ka falënderuar edhe tifozët "Torcida", të cilët me mbështetjen e tyre i japin frymë jetës sportive në qytetin e Mitrovicës.

Ndërsa drejtoresha e DKRS-së, Valdete Idrizi, ka bërë me dije se do të angazhohet maksimalisht në mbështetje të klubeve sportive, ku prioritet i kësaj drejtorie është që Mitrovica të jetë kryeqytet i sportit

në Kosovë.

Juria profesionale sportist të vitit 2022 shpalli Drilon Hajrizin, basketbollist në Klubin KB "Trepça", ndërsa çmimi "Lah Nimani" i është dhënë veteranit dhe futbollistit të mirënjohur Enver Baliu, ndërsa klubi sportiv i vitit 2022 u shpall Klubi i Basketbollit "Trepça". Në këtë festë jubilarë janë ndarë mirënjohje të veçanta edhe për shumë personalitete që kanë kontribuar ndër vite për zhvillimin e sportit në Mitrovicë.

Milwaukee në shtesë mposhti Bostonin, clippersat ndalin Warriorsin

MILWAUKEE, 15 SHKURT - Milwaukee fitoi me rezultat 131-125 ndaj Bostonit në përballjen "big" në mes të dy skuadrave kryesuese të Konferencës së Lindjes. Një ndeshje spektakolare, vendosur në kohën shtesë. Jrue Holiday me 40 pikë e Giannis Antetokounmpo me 36 pikë e 13 rebounde ishin më të mirët në fushë për Bucksin, duke i bërë të pavlefshme 53 pikët e dyshes White/Brogdon për Celtics. Pavarësisht prej humbjes, skuadra e Bostonit ruan përkohësisht kreun në Lindje. Fiton edhe ekipi i Torontos, që falë 30 pikëve të Poeltl, mposhti me



shifrat 123-113 Orlandon. Skuadra kampione e Golden States u mund me shifrat 134-124 nga clippersat, ndeshje ku Kawhi Leonard bëri dallimin në fushë, duke realizuar 33 pikë. Për Warriorsin ai që u dallua ishte Jordan Poole me 28 pikë, por që mbetën për statistikë. Skuadra e Phoenixit mposhti me rezultat

120-109 Sacramenton, ndeshje ku për vendasit u dalluan Devin Booker me 32 pikë e Deandre Ayton me 29 pikë e 11 rebounde. Ekipi i Washingtonit arrin një fitore të rëndësishme jashtë fushës, duke mundur Portlandin me shifrat 126-101. Për miqtë u dallua Kuzma me 32 pikë e Porgingis me 28.

REZULTATET

Milwaukee - Boston	131-125
Toronto - Orlando	123-113
Phoenix - Sacramento	120-109
Clippers - Golden State	134-124
Portland - Washington	101-126

Sainz: Kjo është makina më e mirë Ferrari që kam pilotuar

Një ditë pas debutimit të makinës Ferrari, piloti spanjoll Carlos Sainz ka folur për njëvendëshen që do të pilotojë këtë sezon. Ky është sezoni i tij i tretë me "kokëkuqen", që pritet të jetë edhe më i miri, pas triumfit të parë në karrierë

në Formula 1 vitin e kaluar. "Makina e re është ende si një foshnjë që duhet të rritet, por në provën e parë gjërat shkuan mjaft mirë. Ferrari arriti të sjellë që në testin e parë një makinë që nuk pati asnjë problem. U argëtuam bashkë

me Charles Leclerc, duke u munduar edhe ta kuptojmë makinën e re", ka thënë Sainz. "Dy gjëra më bënë shumë përshtypje dhe ia komunikova skuadrës: Isha shumë komod në makinën e re, njësoj sikur të isha ulur në divan si dhe u

përshtata shumë shpejt me të. Këto janë gjëra të rëndësishme, pasi do të kalojmë orë të tëra duke pilotuar këtë makinë", u shpreh spanjoli. "Një makinë që tani për tani më kënaq, Ferrari më i mirë që kam pilotuar deri më tani. Duhet të

pranoj se është bërë një punë shumë e mirë në çdo aspekt, edhe në pamjen e jashtme. Gjithsesi, është shpejt për të parë çdo detaj dhe anën teknike. Tani të shohim edhe disa teste për të parë ku jemi me rivalët", ka shtuar Sainz.

SHKURT

Mbappe: Në Gjermani shkojmë për të arritur në fazën tjetër

PSG-ja pësoi humbje nga Bayern Muncheni (0-1) në ndeshjen e parë të 1/8 së finales në Ligën e Kampionëve. Pavarësisht prej humbjes, Kylian Mbappe ka shprehur optimizëm se klubi francez mund të arrijë fitore në Gjermani dhe të kualifikohet më tutje. "Jemi në gjendje t'u bëjmë telashe. Do të shkojmë në Munchen për të arritur në fazën tjetër. Të gjithë duhet të jenë të shëndetshëm. Pas asaj që pamë në këtë ndeshje, ne e kuptojmë se mund ta arrijmë qëllimin tonë", ka deklaruar Mbappe.

Nagelsmanni: Asgjë nuk ka përfunduar sa i përket kualifikimit

Trajneri i Bayern Munchenit, Julian Nagelsmann, ka thënë se, pavarësisht prej faktit se skuadra e tij arriti fitore në Paris, asgjë nuk ka përfunduar sa i përket kualifikimit në fazën tjetër të Ligës së Kampionëve. Bayerni e mposhti PSG-në me rezultat 0-1, ndërsa golin e vetëm e realizoi Coman. "Luajtëm mjaft mirë në 25 minutat e para, nuk prisnim që PSG-ja të ishte kaq pasive në fushë. Pjesa e parë në përgjithësi ishte e mirë, ashtu sikurse edhe fillimi i pjesës së dytë. Më pas u kthye në një ndeshje luftarake, duke pasur mjaft kontraste për çdo top. E kishim parashikuar një sfidë të tillë ashtu sikurse edhe fitoren", ka thënë Nagelsmann. "Nuk ka për të qenë e lehtë. Edhe pse do të luajmë në fushën tonë e kërkojmë mbështetjen e tifozëve. Të gjithë e pamë se si shkoi ndeshje kur hyri Mbappe, ndaj asgjë nuk është e mbyllur pavarësisht prej fitores. Do të përgatitemi si duhet", ka deklaruar Nagelsmann.

Conte pas humbjes nga Milani: Asgjë nuk ka përfunduar

Trajneri i Tottenham Hotspurit, Antonio Conte, shprehet i bindur se asgjë nuk përfundoi në "San Siro", ku skuadra e tij pësoi humbje nga Milani (1-0). "Ishte një sfidë me shumë intensitet, e ekuilibruar dhe mes të barabartësh. Bëmë një gabim në golin e pësuar pas vetëm pesë minutash, në atë rast mund dhe duhet të bënim diçka më shumë. Gjithsesi, ky ishte vetëm raundi i parë. I bëj komplimente Milanit. Tani nisim me një avantazh, por asgjë nuk ka përfunduar", ka thënë Conte.

Pioli: Kjo fitore na jep shumë besim
